	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 1 / 12</i>

Në bazë të Nenin 18 të Statutit të Komitetit Nacional CIGRE Kosovë, Bordi Teknik Nacional i KN CIGRE KO në takimin e mbajtur me datë 05.06.2018 ka miratuar:

RREGULLOREN E PUNËS SË KONFERENCAVE DHE TAKIMEVE PROFESIONALO – SHKENCORE

E PËRGJITHSHME

Neni 1

Në përputhje me qëllimet dhe detyrat e KN CIGRE KO, në fushën që i takon bëjnë pjesë përveç aktiviteteve tjera edhe organizimet e takimeve profesinalo – shkencore si konferenca, simpoziume, kollokuime dhe takime të tjera të veçanta (në tekstin vijues: Konferenca), si dhe pjesëmarrja me punime në punimet e konferencave ndërkombëtare të organizuara nga CIGRE-et jashtë vendit.

Neni 2


Sipas nevojës KN CIGRE KO organizon, si rregull çdo dy vite konferencë të rregullt nën emrin “Konferenca e KN CIGRE KO”.

Përveç kësaj, me iniciativën e Komiteteve Studiuese (KS) mund të organizohen takime më të vogla si: simpoziume, kollokuime, etj. për çështje të ndryshme specifike/të veçanta me karakter profesional.

Neni 3

Programi, koha dhe vendi i mbajtjes së Konferencës përcaktohet nga Bordi Teknik Nacional, i cili vendos edhe për Programin e Konferencës, Temat Preferenciale, Temat Studimore (ang. Tutorials), Këshillin Organizativ, Këshillin Teknik, etj.

Programi, koha dhe vendi i mbajtjes së takimeve tjera përcaktohen nga Komitetet Studiuese, varësisht se kush është organizatori, për të cilin duhet të kërkohet paraprakisht aprovimi nga Bordi Teknik Nacional (BTN). Për të gjitha aktivitetet duhet të njoftohet dhe të jetë në dijeni Bordi Teknik Nacional dhe në fund duhet të dorëzohet Raporti mbi aktivitetin e realizuar.

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p>RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE</p>	<p>KN CIGRE KO</p>
	<p><i>ver. 1.0</i></p>	<p><i>page 2 / 12</i></p>

KONCEPTI I KONFERENCËS

Neni 4

Koncepti i Konferencës përgatitet nga Kryesuesi i Bordit Teknik Nacional në bashkëpunim me anëtarët e tjerë të Bordit Teknik Nacional dhe Sekretarin e KN CIGRE KO. Ky koncept duhet të përmbajë të gjitha detajet dhe qëllimet e Konferencës si dhe burimet e financimit. Koncepti i Konferencës duhet të miratohet nga Bordi Teknik Nacional 12 muaj para fillimit të Konferencës.

PËRGATITJET ORGANIZATIVE TË KONFERENCËS

KËSHILLI I PROGRAMIT


Neni 5

Bordi Teknik Nacional e emëron Këshillin e Programit, i cili përbëhet nga Kryesuesit e të gjitha Komiteteve Studiuese. Këshilli i Programit duhet të zgjedh Kryetarin nga radhët e anëtarëve të tij.

Detyra e Këshillit të Programit është të monitorojë punën profesionale të Konferencës nga paraqitja e abstrakteve (përmbledhjeve) e deri te përzgjedhja e punimeve unike (jo kopjuese) si dhe përcaktimin mbi mënyrën e përmbajtjes dhe paraqitjes së tyre.

Këshilli i Programit përgatitë rekomandime për prezantimin e punimeve (p.sh. që tema preferenciale në të cilën do të punohet të jetë e dukshme në ekran, që debatet dhe diskutimet të aplikohen paraprakisht, që të mos lejoj reklamimin e kompanive gjatë prezantimit të punimeve etj.)

Nëse temat dhe prezantimet aktuale janë në përputhje me temat e planifikuara preferenciale, Këshilli i Programit do të krijoj një ekip/grup të ekspertëve për të rishikuar dhe shqyrtuar materialin për secilin punim dhe prezantim. Afati i fundit për dorëzimin e materialeve të prezantimeve është i njëjtë sikurse për dorëzimin e materialit të punimeve.

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p>RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE</p> <p><i>ver. 1.0</i></p>	<p>KN CIGRE KO</p> <p><i>page 3 / 12</i></p>
---	---	---

KËSHILLI I NDERIT

Neni 6

Këshilli i Nderit përbëhet nga personalitete në krye të institucioneve shtetërore, kompanive energjetike, fakulteteve, konsumatorëve të mëdhenj dhe të industrisë, aktiviteti i të cilave është problemi i rrjeteve të mëdha elektrike. Këshilli i Nderit përfshin përfaqësuesit e sponsorit të përgjithshëm, përkrahësit e mëdhenj dhe sponsorët e mëdhenj. Anëtarët e Këshillit të Nderit japin pëlqimin e tyre për të marrë pjesë në Këshill dhe në mbledhjet para mbajtjes së Konferencës, ku kryesuesi i KN CIGRE KO përmes këtyre takimeve iu paraqet atyre konceptin, detajet e punës dhe organizimin e Konferencës.

KËSHILLI ORGANIZATIV

Neni 7

Kryesuesi i KN CIGRE KO emëron Këshillin Organizativ të Konferencës nëntë muaj para fillimit të Konferencës.


Këshilli organizativ është organ punues, detyra e të cilit është kryerja e të gjitha aktiviteteve operative përgatitore për mbajtjen e Konferencës.

Anëtarë të Këshillit Organizativ janë kryesisht anëtarët e Bordit Teknik Nacional, anëtarët e vjetër të KN CIGRE KO dhe/ose njohësit e mënyrës së funksionimit dhe organizimit të Konferencave të ngjashme.

Numri i anëtarëve në Këshillin Organizativ duhet të jetë së paku 5, prej të cilëve: një anëtarë është Sekretari i KN CIGRE KO, dy anëtarë tjerë duhet të jenë nga Operatori i Sistemit dhe Transmisionit si përkrahës i përgjithshëm dhe i përhershëm i KN CIGRE KO. Ndërsa, dy anëtarët e tjerë nga anëtarët e tjerë kolektiv. Për të gjithë këta anëtar është i nevojshëm pëlqimi paraprak i organizatave punuese nga të cilat vijnë anëtarët e Këshillit Organizativ.

Kryesuesi i KN CIGRE KO emëron kryetarin dhe anëtarët e Këshillit organizativ.

Kryesuesi i KN CIGRE KO, menjëherë pas miratimit të Konceptit të Programit të Konferencës merr vendim për formimin e Komitetit Organizativ duke ia përcaktuar saktësisht edhe detyrat.

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 4 / 12</i>

Propozimi i orareve kohore dhe planit financiar do të përgatitet nga Këshilli Organizativ i Konferencës dhe do të miratohet nga Bordi Teknik Nacional në mbledhjen e parë pasuese.

Kryetari i Këshillit organizativ përgatitë dhe nxjerrë propozimin e orarit të detyrave sipas mundësive të mundshme për tu realizuar nga pjesa e anëtarëve të vet. Ky propozim duhet të miratohet nga të gjithë anëtarët e Këshillit Organizativ.

Kryetari i Këshillit Organizativ në mbledhjen e parë të anëtarëve të Këshillit e sjellë Rregulloren e Punës e cila duhet t'i prezantohet Këshillit Organizativ.

Këshilli Organizativ duhet të mbajë takime të rregullta në përbërje të plotë ose të pjesshme, në të cilat ata shqyrtojnë të gjitha çështjet me interes për kryerjen me kohë të aktiviteteve organizative të Konferencës. Për secilën mbledhje duhet të mbahet Procesverbali, në të cilin jepen/caktohen detyra dhe afate kohore si dhe analizohet përmbushja e detyrave dhe afateve.

Për qëllime të vlerësimit real të kontributit është e nevojshme që të gjithë anëtarët dhe bashkëpunëtorët e Këshillit Organizativ të angazhohen sipas nevojës, të shqyrtojnë rregullisht detyrimet e marra dhe të realizuara, të cilat duhet të verifikohen personalisht edhe nga Kryetari i Këshillit Organizativ.

Me propozimin e kryetarit të Këshillit Organizativ, kompensimi i anëtarëve për punën dhe angazhimin në Këshillin Organizativ, duhet të miratohet nga Kryesuesi i KN CIGRE KO.


PËRGATITJET PROFESIONALE PËR KONFERENCË

Neni 8

Përmbajtja e temave profesionale që janë punuar për Konferencën e KN CIGRE KO është e ndarë në grupe.

Tematika e secilit grup duhet të korrespondojë/përgjigjet fushës së veçantë të punës të një Komiteti Studiuës. Bazuar në këtë, grupi e merr emrin e Komitetit Studiuës.

Nëse një grup përfshinë tema dhe programe pune për shumë Komitete Studiuëse, të cilat mund të ndodhin gjatë mbajtjes së Konferencës dhe/ose në takime tjera, atëherë grupi emërohet sipas tematikës. Komiteti Studiuës (ose disa Komitete Studiuëse), çështja e të cilit përpunohet nga grupi, kujdeset për përgatitjen dhe funksionimin e punës së grupit gjatë kohëzgjatjes së asaj mbledhje.

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 5 / 12</i>

Neni 9

Komiteti Studiues (ose disa Komitete Studiuese) që mbulon aktivitetet e grupit duhet që në fazën e përgatitjes për Konferencë të:

- të përcaktojnë temat preferenciale që do të përpunohen në mbledhje;
- organizon rishikimin e punimeve (titujve dhe përmbajtjeve) dhe vendos për pranimin e tyre;
- organizon klasifikimin, rishikimin dhe vlerësimin profesional të punimeve;
- zgjedhë referuesit kryesues dhe profesional të grupeve.

Neni 10

Temat preferenciale për Konferencën e ardhshme miratohen nga Bordi Teknik Nacional që në mbledhjen e parë pas konsultimeve. Për grupe të tjera të temave preferenciale, ato duhet të prezantohen para Bordit Teknik Nacional së bashku me propozimin për mbajtjen e Konferencës.


Neni 11

Përveç miratimit për mbajtjen e Konferencës, Bordi Teknik Nacional jep udhëzime për Sekretarin e KN CIGRE KO lidhur me caktimin e datave për organizimin e Konferencës, paraqitjen e punimeve dhe afatet tjera kohore.

Neni 12

Paraqitjet e punimeve grumbullohen nga Sekretari i KN CIGRE KO dhe në përputhje me afatet e përcaktuara i dorëzohen kryetarit të Komitetit Studiues përkatës. Kryesuesi i Komitetit Studiues në marrëveshje me Sekretarin eliminon/anulon paraqitjet e punimeve që sipas përmbajtjes nuk përshtaten me temat preferenciale. Kryesuesi i Komitetit Studiues informon Sekretarin dhe kthen përgjigjet me shkrim lidhur me kërkesat e refuzuara mbi punimet e paraqitura, duke dhënë shpjegimin e nevojshëm. Sekretari i KN CIGRE KO i informon autorët (sipas emrit të parë në punim) mbi aplikacionet e refuzuara.

Me autorët e aplikacioneve të pranuar, Sekretari i KN CIGRE KO mban kontakte me qëllim që punimet të përpunohen teknikisht në përputhje me Udhëzimet për përgatitjen e punimeve për Konferencë dhe simpoziume të KN CIGRE KO dhe për mënyrën e përshtatshme për shtypje.

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 6 / 12</i>

Neni 13

Të gjithë autorët e punimeve duhet të dërgojnë në formë elektronike materialin e punimit të përgatitur brenda kohës së caktuar në adresë të Sekretarit të KN CIGRE KO. Pastaj, Sekretari përcakton nëse forma dhe fushëveprimi i punës së punimit i korrespondon/përgjigjet Udhëzimeve të dhëna për atë rast dhe nëse ato janë të përshtatshme për përpunim dhe plotësim të mëtejshëm. Punimet që nuk i plotësojnë kushtet/kriteret e vendosura sipas Udhëzimeve duhet t'i kthehen autorit me shpjegime përcjellëse.

Punimi i cili i plotëson kushtet/kriteret e përshkruara në Udhëzuesin Teknik, Sekretari ia paraqet Kryesuesit të Komitetit Studiues përkatës, duke ia dërguar punimin e autorit. Në rastin kur punimi nuk i përket një grupi të deklaruar ku është i destinuar, atëherë Sekretari i KN CIGRE KO ia dërgon punimin atij Komiteti Studiues fusha e të cilit është më e afërt me temën e punimit.

PRANIMI DHE VLERËSIMI PROFESIONAL I PUNIMEVE

Neni 14

Secili punim i dedikuar për Konferencën e KN CIGRE KO, i cili i plotëson kërkesat sipas Nenit 9 të kësaj Rregullore duhet të ketë një vlerësim(shqyrtim) profesional nga ana e ekspertëve.

Neni 15

Vlerësimin(shqyrtimin) profesional e jep recensenti profesional i caktuar nga Komiteti studiues ose nga Kryesuesi i Komitetit Studiues, të cilës tematikë punimi i përket.

Në rast nevojë kur është urgjente dhe në mes të dy takimeve të Komitetit Studiues, Kryesuesi i Komitetit Studiues e përcakton recensentin e punimit dhe lidhur me këtë i/e raporton/njofton Komitetin Studiues në takimin e radhës.


Neni 16

Puna e recensentëve profesional është punë vullnetare.

Neni 17

Detyra e recensentit profesional është:

- për të përcaktuar nëse përmbajtja e punës përputhet me karakterin e Konferencës dhe temave preferenciale;
- për të përcaktuar nëse punimi është i punuar në një nivel të mjaftueshëm profesionalo-shkencor, për të mos paraqitur rezultate dhe konkluzione tashmë

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 7 / 12</i>

të njohura, që punimi nuk ka karakter të reklamimit ose promovimit të produkteve, bizneseve apo individëve, ose sulmeve të çfarëdo lloji. Punimi duhet të jetë një kontribut për sqarimin ose për zgjidhjen e një problemi me të cilin merret Komiteti Studiues me mundësi të aplikimit në praktikë;

- për të përcaktuar nëse dorëzimi i punimit është i konsideruar, ose i referuar, ose i publikuar edhe diku jashtë KN CIGRE KO;
- që pas verifikimit të kriterëve të dhëna, të jepet propozimi që punimi a të pranohet, të dërgohet për përpunim apo shqyrtim shtesë edhe nga Komitetet e tjera Studiuese ose të refuzohet si punim;

Nëse recensenti propozon që punimi të pranohet, atëherë ai/ajo duhet që:

- propozon që punimi është i klasifikuar si referat apo si informacion. Të gjitha punimet të cilat i referohen veprave origjinale me kontribut profesional ose shkencor vlerësohen si referate, ndërsa çdo gjë tjetër është informacion.
- bën një rishikim profesional të përmbajtjes së punimit;
- në bazë të rishikimit profesional, recensenti mund të propozon pyetje për diskutim (gjatë prezantimit të punimit në Konferencë).

Gjithashtu, recensenti mund të propozojë pranim të kushtëzuar të punimit, me kusht që punimi t'i kthehet autorit për përmirësim-plotësim. Përveç shpjegimit, duhet të përcaktohet qartë se çfarë kërkohet nga autori duke ia caktuar edhe afatin kohor për ndryshime, në bazë të kriterëve nga ky nen.

Nëse recensenti propozon që punimi i takon një grupi tjetër, atëherë ai punim do të kthehet të kryesuesi i Komitetit Studiues, i cili pastaj ia dërgon Sekretarit, duke dhënë udhëzime përkatëse se për cilin Komitet Studiues ky punim është i përshtatshëm.


Nëse recensenti propozon refuzimin e punimit, atëherë ai refuzim duhet të përcillet me shkrim duke dhënë shpjegime të arsyeshme.

Recensenti mund të propozojë që punimi veç i pranuar tashmë po shqyrtohet edhe nga një Komitet Studiues tjetër (ose në disa prej tyre) i cili merret me çështje të problematikave të ngjashme. Në këtë rast, Kryesuesi i Komitetit Studiues të i cili është pranuar punimi sipas këtij propozimi e njofton Sekretarin e KN CIGRE KO ta procedoj tutje propozimin e recensentit.

Neni 18

Komitetet Studiuese përcaktojnë afatin për dhënien e vlerësimeve profesionale të ekspertëve për punime në përputhje me konkluzionet (përfundimet) e Bordit Teknik Nacional për oraret kohore (terminët) të mbajtjes së Konferencës.

Neni 19

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 8 / 12</i>

Vendimin përfundimtar mbi pranimin, ndryshimin apo refuzimin e punimit e sjellë Komiteti Studiues përkatës.

Në rastin kur punimi është refuzuar nga një Komitet Studiues, atëherë ai punim nuk mund të shkojë për ri-shqyrtim në një Komitet tjetër Studiues.

Në raste të caktuara, Komiteti Studiues mund të autorizojë kryesuesin e Komitetit Studiues ose recensentin (p.sh. pas kthimit të punimit nga përpunimi) të kthehet për të marr vendimin përfundimtar lidhur me pranimin e punimit.

Neni 20

Kryesuesi i Komitetit Studiues informon Sekretarin për rezultatet e vlerësimit të punimeve dhe klasifikimin e tyre, në mënyrë që pastaj të ndërmerr veprime të nevojshme për përgatitjen, shtypjen dhe shpërndarjen e punimeve.

RAPORTUESI PROFESIONAL

Neni 21

Për secilën Konferencë (grup në kuadër të konferencës), Komiteti Studiues e cakton një Raportues profesional, ose më shumë, varësisht nga tematika.

Raportuesit profesional bëjnë rishikimin e punimeve dhe recensimin e tyre dhe përpilojnë Raport me shkrim mbi një grup të punimeve për Konferencë. Raporti duhet të përfshijë parametra të rëndësishme, karakteristika të përbashkëta dhe konkluzione për grupet e punimeve, dhe me vështrime/pikëpamje kritike, pyetje për diskutim, përmes të cilave do të fillonin diskutimet në kuadër të temave preferenciale.


SHUMËZIMI DHE SHPËRNDARJA E MATERIALEVE

Neni 22

Mënyra e shumëzimit dhe numri i kopjeve të punimeve përcaktohet nga Bordi Teknik Nacional. Sekretari i KN CIGRE KO merret me kopjimin dhe shpërndarjen e materialeve të shkruara për Konferencë. Mbledhja e të gjitha punimeve për Konferencë zakonisht përgatitet dhe shpërndahet në formë elektronike.

Neni 23

Komitetet Studiuese brenda afatit të miratuar duhet të përfundojnë pranimin e punimeve për Konferencë, me qëllim që të mundësohet shumëzimi dhe shpërndarja e materialeve. Afati i fundit është të paktën një muaj para fillimit të Konferencës.

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE	KN CIGRE KO
	<i>ver. 1.0</i>	<i>page 9 / 12</i>

PUNA NË KONFERENCË

Neni 24

Puna e Konferencës zhvillohet në grupe sipas programit të aprovuar nga Bordi Teknik Nacional. Nëse dy ose më shumë grupe punojnë në të njëjtën kohë atëherë orari i punës duhet të jetë i atillë që nëse është e mundur grupet me tema të ndryshme mund të funksionojnë/realizohen njëkohësisht.

Neni 25

Sipas rregullit, puna e grupit në Konferencë menaxhohet (kryesohet) nga Kryesuesi i Komitetit Studiues, fushëveprimi i të cilit i takon grupit, me ndihmën e Raportuesit profesional. Nëse kryesuesi i Komitetit Studiues është i penguar ose tema e mbuluar nga Komitetet Studiuese është e ndarë në disa grupe, atëherë Komitetet Studiuese do të emërojnë kryesuesit(përfaqësuesit) e tyre për secilin grup.

Neni 26

Raportuesi profesional propozon një përmbledhje të diskutimeve dhe përfundimeve.

Trupi punues i Komiteteve Studiuese me propozimin e Raportuesit profesional përgatitë propozim të konkluzioneve të miratuara nga Komitetet Studiuese.

Teksti përfundimtar i konkluzioneve miratohet në mbledhjen në fund të Konferencës, ose nëse nuk ka mbledhje, atëherë që në takimin e parë të Komiteteve Studiuese pas punës së grupeve.


Konkluzionet duhet t'i dorëzohen Sekretarit të KN CIGRE KO jo më vonë se 10 ditë pas përfundimit të Konferencës.

Neni 27

Sekretari i KN CIGRE KO harton Raport me shkrim mbi Konferencën e rregullt. Për takimet e tjera, Raporti përgatitet nga Sekretari ose në marrëveshje me kryesuesin e Komitetit Studiues që e organizon takimin. Raporti duhet të printohet(shtypet) dhe të dërgohet te të gjithë pjesëmarrësit e regjistruar të takimit.

Neni 28

Plani i shpenzimeve të Konferencës dhe shuma e tarifës(kuotizimit) për pjesëmarrësit në Konferencë caktohet dhe miratohet nga Bordi Teknik Nacional. Analiza përfundimtare e të ardhurave dhe shpenzimeve të Konferencës miratohet nga Bordi Teknik Nacional në kuadër të bilancit të rregullt vjetor.

	<p>Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë</p> <p>RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE</p> <p><i>ver. 1.0</i></p>	<p>KN CIGRE KO</p> <p><i>page 10 / 12</i></p>
---	---	--

DHËNIA E DIPLOMËS PËR PUNIMIN MA TË MIRË

Neni 29

Për të stimuluar dhe rritur cilësinë e punimeve dhe për të dhënë njohje dhe mirënjohje autorëve për punimet me peshë të veçantë jepen diploma të përshtatshme për punimin më të kërkuar.

Neni 30

Diploma duhet të përmbajë tekstin si në vijim:

Bordi Teknik i Komitetit Nacional CIGRE Kosovë ka vendosur sipas propozimit të Komitetit Studiues (numri dhe emri i KS) për t'i ndarë

DIPLOMË

(emri & mbiemri ose emri i autorit të punimit)

për punimin: (titulli i punimit), i dorëzuar në Konferencën e ____ të KN CIGRE KO dhe vlerësohet si punimi më i rëndësishëm nga sfera e Komitetit Studiues.

Diploma duhet të nënshkruhet nga Kryetari i Bordit, nga Kryesuesi i Komitetit Studiues dhe nga Sekretari.

Neni 31

Çdo Komitet Studiues mund të paraqet një propozim për dhënie të një diplome. Propozimi mund të dorëzohet nëse të paktën 5 punime janë dorëzuar nga sfera e Komitetit studiues.


Neni 32

Në rastet kur ka më shumë se një autor të punimit më të mirë, atëherë secili autor do të marrë një kopje të diplomës me të njëjtin tekst (me emrat e të gjithë autorëve).

Neni 33

Procedura për përzgjedhjen e punimit më të mirë është si më poshtë:

- punimi ma i mirë zgjidhet me votimin e anëtarëve brenda Komiteteve Studiuese përkatëse;
- më shumë se gjysma e anëtarëve të Komitetit Studiues përkatës duhet të jenë të pranishëm në mbledhjen e Komitetit Studiues kur të mbahet votimi;
- Votimi është i fshehtë;

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE <i>ver. 1.0</i>	KN CIGRE KO <i>page 11 / 12</i>
---	---	---

- punimi më i mirë përzgjidhet ai që merr ma së shumti vota. Në rastet kur dy ose më shumë punime marrin numër të njëjtë të votave, atëherë votimi duhet të përsëritet vetëm për ato punime;
- në Procesverbalin e mbajtjes të mbledhjes së Komitetit Studiuës, përveç listës së anëtarëve të pranishëm duhet të jenë edhe nënshkrimet e secilit anëtarë prezent në atë mbledhje.

Propozimi me rezultatet e votimit në formë të shkruar jepet nga kryesuesi i Komitetit Studiuës dhe i dërgohet kryetarit të Bordit Teknik Nacional.

Neni 34

Kriteret që duhet të marren parasysh për dhënien e diplomës për Punimin më të mirë janë:

- originaliteti dhe niveli profesional i përgatitjes së punimit;
- shkalla e përfitimit të dobive në zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike dhe arritjen e qëllimeve të KN CIGRE KO.

Neni 35

Diplomat u jepen/dorëzohen fituesve në takimin e parë të Komitetit Studiuës përkatës, pas përfundimit të Konferencës.

TAKIMET E PËRGJITHSHME NDËRKOMBËTARE TË CIGRE-ve

Neni 36


Të gjitha punimet që anëtarët e KN CIGRE KO i shkruajnë për konferencat e CIGRE-ve të vendeve të huaja duhet të dorëzohen te Sekretari i KN CIGRE KO, i cili pastaj pas rishikimit(recensimit) të tyre, ia dërgon/përcjell organizatorit të konferencës jashtë vendit.

Neni 37

Punimi duhet të përmbush në mënyrë strikte kushtet sipas formës dhe fushëveprimit të përcaktuara nga organizatori i konferencës ndërkombëtare. Secilin material/punim që dërgohet jashtë vendit, një kopje e tij duhet të mbahet në arkivin e KN CIGRE KO.

Neni 38

Puna e planifikuar jashtë vendit duhet t'i dorëzohet sekretarit të KN CIGRE KO të paktën 30 ditë kalendarike përpara afatit të caktuar(nga organizatori) të mbajtjes së takimit ndërkombëtar. Kjo vlen për paraqitjen e abstraktit(sinopsisit) dhe punimit.

	Këshilli Ndërkombëtar për Rrjetet e Mëdha Elektrike Komiteti Nacional CIGRE Kosovë RREGULLORE E PUNËS SË KONFERENCAVE <i>ver. 1.0</i>	KN CIGRE KO <i>page 12 / 12</i>
---	---	---

Neni 39

Kryesuesi i Komitetit Studiues, tema e të cilit është më e afërt, duhet të caktoj dy rishikues(recensentë) për të shqyrtuar çdo punim të përgatitur për një takim ndërkombëtar. Recensenti duhet të jetë një ekspert/profesionist i cili nuk ka nevojë të jetë anëtarë i KN CIGRE KO.

Bordi Teknik Nacional i KN CIGRE KO krijon grup punues i cili bën përzgjedhjen se cilat punime duhet të dërgohen në takime të ndryshme të CIGRE-ve ndërkombëtare.

Neni 40

Pas pranimit të raportit nga recensenti, Komitetit Studiues të cilit i takon punimi vendos për pranimin ose jo të punimit d.m.th. duke e rikthyer për ri-përpunim të punimit apo për refuzim tek autori, së bashku me shpjegimin përkatës.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Bordi Teknik Nacional është përgjegjës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe polemikave profesionale që mund të lindin në lidhje me punimet, punimet e tjera të ekspertëve apo diskutimet. Çështjet financiare dhe organizative që lidhen me mbledhjet apo takimet e ekspertëve zgjidhen nga Bordi Teknik Nacional sipas propozimit të Komitetit Studiues përkatës ose sipas propozimit të Kuvendit të Komitetit Nacional.

Neni 42


Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregullore do të kryhen në përputhje me procedurën e parashikuar për miratimin e saj.

Neni 43

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Bordi Teknik Nacional(BTN) të KN CIGRE KO.



Kryetar i KN CIGRE KO
(Kryesues i BTN-së)



Prof. Dr. Mehmed BULA

Datë: 05.06.2018, Prishtinë